

Informata dhe Sqarime te nevojshme
Firma: "EPES GROUP" shpk (per vitin 2018)

I Te dhenat mbi shoqerine.

Shoqeria EPES GROUP shpk eshte regjistruar ne QKR me date 20/11/2012 dhe indetifikuar me NIPT L22320017F, me objekt veprimtarie **Import eksport dhe tregtim te artikujve te ndryshem elektrike dhe elektronike.**

II Politikat dhe rregullat krvesore te Kontabilitetit.

Bilanci dhe pasqyrat financiare jane hartuar sipas kerkesave te Standardit Kombetare te Kontabiliteti Nr 2, ne baze te ligjit te kontabilitetit Nr. 9228 Dt. 29.04.2004.
Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, duke e kombinuar me elementete metodave te tjera dhe parimit te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Leke Shqiptar (leke).

III Gjendja e llogarive te pasqyrave te bilancit dhe PASH.

A. Mjetet monetare

Mjetet monetare perfshijne mjetet monetare ne arke, banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentet e mjeteve monetare jane investime afatshkurtra, shume likuide dhe te gatshme per t'u konvertuar ne shuma te njohura te mjeteve monetare dhe te cilat nuk jane objekt i nje rreziku domethenes te ndryshimeve ne vlere. Kurset e kembimit, te perdorura nga shoqeria per monedhat e huaja, me 31.12.2018 jane 1 euro=123.42 leke dhe 1 dollar =107.82 leke.

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave.

B. Aktive te tjera afatshkurtra

Ne aktive te tjera afatshkurtra kemi keto llogari:

- Llogaria "Kerkesa te arketueshme" perbehet nga klientet te cilet kan blere mallra dhe nuk kan bere pagesen deri me 31.12.2018

A. Inventaret

Inventaret jane njohur, ne perputhje me percaktimet e bera ne SKK-4 "Inventaret", kur shoqeria i kontrollon apo zoteron ato ekonomikisht apo ligjerisht, kur mbart te gjitha rreziqet dhe perfitimet ne lidhje me to, dhe kur kostoja matet ne menyre te besueshme. Ne hyrje inventaret e mallrave dhe materialeve vleresohen me koston e tyre qe përfshin teresine e çmimeve te blerjes dhe te shpenzimeve te bera per ti sjelle inventaret ne kushte magazinimi, kur keto kosto mund te identifikohen me besueshmeri.

Gjendja e inventareve ne bilanc perbehet nga mallra qe ndodhen fizikisht ne ndermarrje

B. Aktivet Afatgjata Materiale

Aktivt afatgjata materiale (AAM-te) bazohen ne modelin e koston. Ne bilanc, nje element i AAM-se paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

C. Huat dhe detyrimet

Detyrimet ndaj shtetit per tatimet dhe per kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqerore dhe shendetesore paraqiten me shumën e tyre te llogaritur sipas kerkesave ligjore ne fuqi ne daten e ndërtimit te pasqyrave financiare.

D. Kapitali

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2017 ai eshte 100 leke.

Te ardhurat dhe shpenzimet

Te ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit te drejtave te konstatuara. Te ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i jane kaluar bleresit te gjitha rreziqet dhe perfitimet, maten me besueshmeri dhe ka siguri te mjaftueshme ne marrjen e perfitimeve. Te ardhurat vleresohen me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme, duke marre parasysh shumen e skontimeve ose rabatat e ofruara.

Shpenzimet njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqeria pret te dalin aktive per shlyerjen e tyre ne te ardhmen. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen te ardhura prej tyre, pavaresisht nese jane faturuar apo paguar ato.

Llogarite e te ardhurave dhe shpenzimeve jane paraqitur qarte ne pasqyrat financiare dhe nuk kan nevojë per sqarime ose detajime.

Administratori

JULIANA AGA



Hartuesi

Eglantina Xheka

